



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Asamble

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 06/2015

Prishtinë, më 27.01.2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamt Mustafa, kryetar, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca - anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Visar Ymeri, Pal Lekaj, Fatmir Limaj dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrësi i ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Vllaznim Krasniqi, Naim Zeqiri, Maria Dodaj, Ramadan Sejdiu dhe Agim Kukaj-MZHE; Lumnije Murati-ZPRK; Dardan Abazi dhe Burim Ejupi-INDEP dhe Delfinë Elashani -GLPS.

Pjesëmarrës nga mediat: Shkodran Gajraku- Klan Kosova; Kushtrim Ahmeti –KTV; Majlinda Doda- RTK- Radio dhe Pranvera Musa- Kosova-Press.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave: 13, 16 dhe 19.01.2015;
3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, me theks të veçantë me gjendjen në ndërmarrjet publike dhe telekomunikacionin;
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave: 13, 16 dhe 19.01.2015

Procesverbalet nga mbledhjet e datave 13, 16 dhe 19.01.2015 u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci, me theks të veçantë me gjendjen në ndërmarrjet publike dhe telekomunikacionin

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë mbledhje të Komisionit është i ftuar për raportim ministri për Zhvillim Ekonomik, Blerand Stavileci lidhur me çështjen aktuale të ndërmarrjeve publike si numër një dhe përdorimi më i mirë në interes publik të aseteve publike. Në këtë drejtim pra sa i përket ndërmarrjeve publike ato i mbikqyr drejtëpersëdrejt Ministria por përgjegjësia është e parlamentit që t'i mbikqyr ato nëpërmes Ministrisë, por edhe bordet e ndërmarrjeve mund të ftohen në Komision. Ai shtoi se Komisioni gjithmonë do të bashkpunojmë me Ministrinë në këtë drejtim, dhe theksoi që është shumë me rëndësi t'i ndëgjojmë preokupimet e ministrit në këtë çështje jashtëzakonisht të rëndësishme. Në vazhdim ai tha që dihet se këtu kemi sfida shumë të mëdha në realizimin e qeverisjes korporative, në ruajtjen e aseteve, kemi sfida shumë të mëdha në investimet, si t'i bëjmë këto ndërmarrje tërheqëse për investitor, kemi sfida të mëdha në performancën e tyre, mënyren se si do ta konstatojmë atë performancë, çka do të bëhet pasi ta konstatojmë performancën adekuate, kemi pasur rastin kur jo për shkak të cilsisë së raportit që ka ardhur nga njësia monitoruese, por për shkak të performancës jo të mirë të një pjese të ndërmarrjeve raporti nuk ka kaluar në Kuvend, por mandej ka mbetur aty nuk ka shkuar më tutje, ne mandej duhet të shohim se çka do të ndodhë më tutje në raste të tilla kur referohet rasti i performancës. Ne kemi në një procedurë siç dihet ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndermarrjet Publike që sot do ta diskutojmë gjatë planit të punës, aty kemi çështje që janë kryesisht të lidhura me aspektin e transformimit të ndërmarrjeve shoqërore në ndërmarrje publike që janë çështje të ndërlikura me to, por ne edhe në Komision kemi diskutuar që të shihet nëse ka nevoja për përmirsim në bashkpunim me ministrin të bëjmë bashkarisht një përmirsim në segmente të caktuara, por ju lutem që Ministria çka ka nevojë mund të bashkpunojë me neve që të shohim lidhur me disa ndryshme që janë të domosdoshme, që kishin me lehtësuar funksionimin e ndërmarrjeve publike. Pastaj Mustafa fjalën ia kaloi ministrit Blerand Stavileci për raportim, dhe tha se pas raportimit mandej mund të bëjmë pyetje, sygjerime, komente nga deputetet.

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik (MZHE) – Faleminderit kryetar, të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri është knaqësi për mua nga ato gjashtë mbledhje që ju keni mbajtur unë kam qenë në pesë nga ato dhe kemi biseduar, por ndoshta sot do të kemi më shumë hapsirë për të biseduar, për të cilën temë jam ftuar për të raportuar para jush. Siç e thatë ju më heret, ne ishim sëbashku në një konferencë të organizuar enkas për Ndermarrjet Publike, me qenë se aty theksi i veçantë ishte për ndikimin e ambientit të biznesit dhe menxhimit të ndërmarrjeve publike, unë edhe pse është një kohë e shkurtër por kur e shiqojmë është thuajse më pak se një muaj që kam marrë detyren, unë do të ja them një përmbledhje të përgjithësuar të asaj se çfarë bënë sot për sot Ministria e Zhvillimit Ekonomik por edhe menjëhere edhe disa sygjerime apo dilema që do t'i kishim për të ardhmën ku mendoj që do të jetë jetike bashkpunimi ngushtë në mes të ministrisë, komisionit parlamentar siq e thashë edhe më heret ne konferenc, ndermarrjet private sado që ato nuk bien në

kompetencën tonë. Ne, si Qeveri, kemi një komitet ndërmjetësues ministror ku i trajnojmë këto kërkesat e tyre që derivojnë nga Ligjet për ndërmarrjet publike për themelimin e ndërmarrjeve publike lokale ku mendoj që edhe kjo është në interes që ti diskutojmë sepse parimet e përgjigjithshme mendoj ato që vlejnë për ndërmarrjet publike të nivelit qendror një pjesë e madhe e tyre do të duhet të lidhen me parimet univerzale sidomos ato që lidhen me pjesën operative kodin e etikës edhe për ndërmarrjet publike lokale. Pra siq e dini, vazhdoi Ministri, tek ne ekzistojnë 17 ndërmarrje publike qendrore ndërsa në nivelin lokal kemi 43 ndërmarrje publike lokale dhe sëbashku pra janë diku rreth 60 të tilla, me 60 borde, me qindra shërbime e me mijëra probleme. Ne e dimë se si ka rrjedhur procesi rreth themelimit të tyre, pra në vitin 2006 kur është bërë korporatizimi dhe e dim se në bazë të cila Ligjeve ato veprojnë mirëpo në përgjithësi nëse i shofim nga treguesit e performancës nga raportet që janë bërë ndër vite ne e shofim që të pjesa më e madhe e tyre kemi të bëjmë me zhvillime positive, natyrisht që kemi progres por që disa prej tyre kemi edhe regres sidomos në qendrueshmërinë financiare. Unë kam thënë edhe më heret dhe po e përsëris prap për të funksionuar një qeverisje korporative dhe keto dy dokumente që unë i quajta si udhërrëfyes, kushtetutarë për ndërmarrjet publike pra qeverisja korporative dhe kodi i etikës ne duhet të gjejmë një pikë ekuilibruese në mes të disa faktorëve që ndikojnë pastaj për ta mbajtur bilancin lidhur me këto ndërmarrje, duke ja filluar nga apsketi i strukturave njerzore të atyre që udhëheqin por duke e marrë parasysh gjithëherë qendrueshmërinë financiare, cilësinë e shërbimeve, mardhëniet me konsumator, inkasimet dhe po ashtu edhe përgjegjësinë sociale të këtyre korporatave. Ai tha se ne e shofim tek një pejsë e madhe gjatë këtyre viteve Qeveria e Republikës së Kosovës duke përfshirë edhe vitin e kaluar pra ka financuar mbi 30(tridhjet) projekte dhe disa prej tyre të kategorizuara në projekte të subvencioneve pra për çështjen e pagave dhe për disa të tjera nga kategoria e investimeve kapitale. Natyrisht ne nuk mund ti mohojmë disa zhvillime dhe disa fakte pozitive që kanë ndodhur nëse e marrim në harkun kohor të shumë viteve e sidomos prej periudhës kur ato janë korporatizuar nga viti 2006 e kendej ne shohim në përgjithësi se tek shumica ka një progress pra që sot sido që të jetë krahasuar me periudhat e kaluara ka më shumë furnizim me ujë dhe më pak humbje, ka poashtu regjenerim të industrisë dhe ka shërbime më të mira të ujesjellsit po ashtu edhe te një pjesë e tyre edhe rritje të inkasimit edhe nga këto pra Qeveria në nivelin qendror nëpërmjet edhe projekteve kapitale shohim se në masë të madhe del që shum prej atyre kanë realizuar pozitivisht edhe në rritjen e qendrueshmërisë së tyre financiare por edhe në ofrimin e shërbimeve më cilësore sidomos tek sektori i ujrave dhe ngrohjes. Kemi zhvillime pozitive edhe në kuptimin e rritjes së performancës, të zgjerimit të shërbimeve të tyre, ofrimit të shërbimeve më cilësore sidomos me investimet që janë bërë dhe që edhe ju jeni dëshmitar edhe nga njëra edhe tjetra pra tek uji dhe ngrohja, dhe duhet theksuar që këtu kemi një komunitet të donatorëve shumë aktiv, sidomos një pesëshe të donatorve të sektori i ujrave të cilët janë vazhdimisht të interesuar për investime në këtë sektor dhe në ujrë e zeza me tri komunat e Dugagjinit, Prizrenin, Pejen dhe Gjakovën. Duhet theksuar njëjtë se edhe nga takimi të cilin e kemi pasur me donatorët dhe ambasadat përkatëse, agjencitë apo organizatat të cilat i realizojnë këto projekte apo na asistojnë neve në aspektin financiar janë zotuar që do ta mbeshtesin sektorin e ujesjellsit por edhe te ngrohjes qendrore të fazës së dytë të Termokosit për zgjerimin e rrjetit. Gjatë kësaj periudhe unë kam takuar pjesën më të madhe të këtyre ndërmarrjeve, kryesuesit e bordeve, kryeshefat por edhe në të njëjtën kohë ne kemi marrë leter nga Kuvendi edhe nga Zyra e Kryeministrit, pra duke e ditur që në pjesën më të madhe të Ndërmarrjeve publike ka borde me afate të skadauara ose i kanë të pa kompletuara dhe është në obligimin tonë që në relacionin e zhvillimit ekonomik dhe zyrja e Kryeministrit perkatesisht ta autorizojmë sekretarin e zyrës së Kryeministrit që ti shpall konkurset për emrimin e këyre bordeve. Dhe mendoj që nomentin kur një gjë e tillë të jetë e përkufizuar dhe të jete e kompletuar ather që ne sigurisht që do të duhej të hapnim një periudhë të re të ndërmarrjeve publike dhe gjithmonë duke e ditur rolin e kufizuar që e ka Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sepse ne e dimë, qoftë ne kuader të Qeverisë qoftë edhe ne relacion Qeveri edhe Parlament, në këtë rast Deputetët pra shpeshherë ndoshta edhe nuk e kuptojmë shpeshherë relacionin dhe si është e ndertur ky system dhe cilat janë përgjegjësit e

Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe mendohet që ato ndermarrje janë pjesë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ne kemi në kuder të Ministrisë për politika dhe monitorimin e ndermarrjeve publike z.Sejdiu është udhëheqës i saj dhe ne punojm dhe veprojmë në bazë të Ligjit për Ndermarrjet Publike. Ndermarrjet publike neve na raportojnë në baza të rregullta periodike ashtu siq e parasheh Ligji dhe ne pastaj këto ja kalojme Kuvendit. Ai shtoi se mendoj që ne nuk do të mund të jemi fleksibel vetëm në anën e transparencës në formatim dhe ma shumë ndoshta në elemente teknike të përgaditjes të një raporti në mënyrë që të jetë më i kuptueshëm dhe më i lexueshëm për Deputetët, përndryshe do të ishte shumë e mirë besoj një praktik e re që për problem të caktuar të ftohen edhe ata në mënyrë që most ë kemi një shkëputje të dihet se kush është përgjegjësi sepse edhe ata që marrin përgjegjësi qoftë si anëtar të bordit qoftë si kryeshefa të këtyre ndermarrjeve mendoj që edhe ata duhet ta ndiejnë barrën e përgjegjësisë dhe për gjerat që lidhen me MZHE natyrisht që edhe ne do të reagojmë, kur për gjërat që nuk lidhen drejtpërsdrejt me mandatin e MZHE-së të gjinden forma, mekanizma dhe instrumente ligjore që ata duhet të japin përgjegjësi, mos ta marrim vetëm anën negative qoftë edhe anën positive. Kur ne kemi një ndermarrje e cila afaron mirë e cila ka një projekt kapital e cila kërkon mbështetjen edhe të Ministrisë edhe të Kuvendit, ku besoj që ju e keni të njëjtin disponim si ne pra, për të ndihmuar ato sidomos të pjesa e investimeve kapitale me çka ato do të mund të fuqizoheshin do të favorizoheshin asetet e tyre pra që janë pronë publike, dhe në të njëjtën kohë do të përmirsohej edhe performanca apo treguesit afarist ekonomik që lidhen enkas me këto ndermarrje publike. Kjo do të ishte një përmbledhje e përgjithshme për momentin se si ne e shohim gjendjen e tyre, tash për tash unë mendoj që mbas kompletimit të bordeve do të hapet një kapitull e re. Ai ai u shpreh se Komisioni, së bashku me Ministrinë, Qeverinë, Ministrinë përkatëse që lidhen me sferat e Ekonomisë dhe zyren e Kryeministrit ta kemi një grup punues, ne e kemi një rregullore të vitit 2013 për kriteret e ndermarrjeve publike, mendoj që aty do të duhej diçka të ndryshohej të plotësohet edhe për ndermarrjet publike për themelimin e ndermarrjeve publike sepse sidomos në ndermarrjet publike lokale ne kemi problem ku shpeshherë derivojnë si rezultat i atyre se kënd e kanë kryetar por nuk përputhen me politikën buxhetore dhe stabilitetin makrofiskal sepse ne e dimi që kur ato kanë probleme dhe nuk janë të qëndrueshme finaciariisht dhe nuk janë likuide dhe solvente dhe pastaj bie barra te Qeveria të busxheti i Qeverisë. Prandaj mendoj që këtu me një kujdes të veçantë të shtuar t'i trajtojmë dhe ta kemi një rregullore që të procezojmë këto që mos të binim barrë. Ai informoi se kemi pasur dy takime të komitetit nderministror për ndermarrjet publike dhe kemi trajtuar ankesat e komunave që kanë kërkuar themelimin e ndermarrjeve lokale, bëhet fjalë për Prizrenin, Ferizajin e Gjiçanin në ndërkohë kanë ardhur edhe dy dergesa nga Prishtina dhe Graçanica, mirëpo të gjithë anëtarët e komitetit nderministror kush ma shumë e kush ma pak kemi shfaqur dilemat se si të ecim tutje sepse në çdo javë mbledhemi dhe flasim për të trajtuar kërkesat e komunave për themelimin e ndermarrjeve lokale. Kemi dashur që të trajtojmë me kujdes dhe mendoj që edhe këtu do të na duhet edhe mbështetja dhe bashkëpunimi i këtij komisioni dhe në përgjithësi i Kuvendit dhe i komisioneve të tjera të cilat kanë lidhshmëri me fushën e Ekonomisë. Për sa i takon fushën tjetër që ju e keni precizuar këtu unë do të flas në përgjithësi për fushën e teknologjisë informative dhe të komunikimeve informatike pastaj do të flasim edhe për telekomunikacionin duke e shfrytëzuar edhe prezencën e drejtorit në anën time të djathtë të teknologjisë informative z. Kukaj edhe për pyetjet dhe gjerat të cilat i kemi më konkrete. Ministri tha se fusha e teknologjisë informative dhe komunikimeve elektronike do të jetë njëri nga prioritetet e Qeverisë, ne edhe dje e kemi procesuar në Qeveri këtë gjë në pajtim me Komisionin Evropian. Për ne shtoi Ministri është si një udhërrefyes për fushën e ekonomisë dhe ne aty kemi arritur edhe mbas diskutimeve që kemi pasur me sektorin privat por edhe me këto ndermarrje publike në fushën e teknologjisë informatike, ta transformojmë në një prioritet Qeveritar ku në formë të ndryshme do të ketë mbështetje në ato ndermarrje që ofrojnë shërbime të teknologjisë informatike. Po ashtu do ta kemi një strategji të teknologjisë informatike, do të punojmë me disa fusha që punojnë drejtpërdrejt të cilat i prekin si në këtë rast edhe PTK-në për të ofruar shërbime më të mira dhe më cilësore për klientet e tyre që një pjesë e tyre jemi edhe vet ne. Në vazhdim të kësaj teme

Ministri tha se është edhe çështja e përdorimit të infrastrukturës e sidomos e 3G-së për të cilat ne kemi edhe kërkesa konkrete për ato, për shfrytëzim të brezit frekuencor, dhe mos të harrojmë që në këtë fushë përveq Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e cili është bartëse e politikave hartuese që lidhet me sektorin, ne kemi edhe një autoritet rreugllativ. Po ashtu ai shtoi se i kemi diskutuar edhe lidhur me njerën ndër prioritetet për të cilën ne kemi menduar për një fond të teknologjisë apo invencionit të lidhjeve informatike i cili do të ishte një injeksion i nevojshëm për sektorin privat, ku ne sot e shohim që ka një potencial të hatashëm me të cilin një pjesë e madhe e rinisë tonë do të mund ta orientonin dijen dhe njohurin e tyre në këtë fushë. Ndërmarrjet private me mbështetje të ndryshme financiare qoftë nga fondet publike qoftë nga fondet garantuese që mund të bënim ne me bankat garantuese me donator të ndryshëm të kemi akses më të lehtë në financa dhe të kemi zgjerim më të madh në zhvillimin ekonomik të tyre dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Për sa i takon pra PTK-së ju e dini që ne në programin Qeveritar i cili është lexuar edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Kryeministri kemi thënë se do ta rivlersojmë strategjinë pra për PTK-në, mendoj se të gjithë e dimë se çfarë ka ndodhur me një proces i cili nuk ka përfunduar, me një proces i cili ka zgjuar debate të shumta sidomos në Kuvend por mendoj se si partner të koalicionit do marrim një afat meritore që të kemi në rend të ditës PTK-në, pra vlersimin e një strategjie e cila do të na shërbente neve për të na dhënë rekomandime në bazë të analizave të mirfillta që nbeshteten me ekspertizë në fakte të argumenteve ekonomike dhe shkencore se si ne duhet të veprojmë në të ardhmën. Ai tha se në këtë moment nuk mund të paragjykojmë asgjë për të ardhmën e saj e dimë që të dy partnerët e koalicionit kemi këndvështrime të djathta dhe besoj që kur e themë këtë secili prej nesh e din se për çka po aludoj, mirëpo asnjëherë pa paragjykuar, sepse secili nga ne ketu mund të kemi mendime iluzione se si do të duhej të veprohet në të ardhmën nuk mendoj që do të duhej ta kemi komoditetin që secili prej nesh në mënyrë arbitrare ta thotë apo ta japë një propozim, por ta kemi një strategji të mirfillt me të cilën mund ta identifikojmë një të ardhme për këtë organizatë që është sot për sot e cila mbetet njëra ndër më profitabile të vendit tonë. Në fund theksoi se keto ishin dy përmbledhjet të shiqua nga këndvështrimi im dhe të Ministrisë për sa i takon këtyre dy fushave besoj që secili prej jush do të marrë pjesë në këtë diskutim do të shfaqni mendime, ide, sygjerime por po them prap pjesmarrja ime dhe e dy zyrtarëve tjerë z.Kukaj dhe z. Sejdiu do të na mundëson që të jemi edhe më të hapur, më konkret dhe më të saktë në përgjigjet tona karrshi pyetjeve të juaja.

Kryetari Muhamet Mustafa - faleminderit Ministër me këtë që prezantuat ju mendoj që tregon që keni marrë punën në dorë ju dhe ne mund të presim ndryshime të domosdoshme në këtë sferë. Edhe po më pëlqejnë këto prioritetet ashtu siç thanë ju shumë gjëra të cilat janë mjaft të rëndësishme strategjia kombëtare për PTK, telekomunikimet, digjitalizimet këto janë gjëra që neve vetëm mund t'i përshëndesim ku besoj që do të kemi rastin që një ditë ti diskutojmë bashkë. Në vazhdim kryetari Mustafa tha se ajo që sot përbënë brengë edhe për Komisionin edhe për shoqërinë është se si ndërmarrjet publike t'i bëjmë më efektive, si ta përmirsojmë performancën e tyre si të ndikojmë që të rritet vlera e aseteve të tyre dhe cilësia e shërbimeve që u jepen qytetarëve. Në këtë drejtim sfidat më të mëdha pra kanë të bëjnë me zgjedhjen e bordeve tash Qeveria ka shpallë konkursin, pra është një punë e madhe sepse janë 17-të ndërmarrje pra me qindra njerëz që duhet të shifet se si do të zhvillohet ky proces, në këtë drejtim ashtu siq e thashë unë është shumë me rëndësi që në bordet t'i bëjmë përgjegjëse sepse nganjëherë e gjithë barra bie mbi kryeshefat ekzekutiv e bordet kanë vetëm përfitime por kurrë nuk japin llogaridhënie, edhe për fakturat kur kemi biseduar edhe tash kur diskutojmë në gjithë i targetojmë kryeshefat ekzekutiv me të drejtë ata kanë përgjegjësi por në qoftë se ne i emrojmë bordet edhe ata kanë përfitime edhe ata ndaj Kuvendit edhe ndaj Qeverisë bordet janë përgjegjëse, edhe ne duhet të zhvillojmë procedurat e matjes së performancës së tyre. Ai tha se kam parë Nenin 7 të Ligjit i cili përcakton një përgjegjësi të tyre dhe përcakton mundësinë e thirrjes së tyre në përgjegjësi, mirëpo kjo nuk ka ndodhë, ku besoj që nuk ka ndodhë sepse ne nuk i kemi qartësuar deri në fund procedurat, kriteret, mënyrën e tyre, kështu që ju lutem mirë që është ketu edhe z.Ramadani ta shiqojmë që ai Nen a është plotësisht i drejtë që ne të kërkojmë përgjegjësinë apo tani të futim

ndonjë korigjim, me qenë se jemi duke e diskutuar Ligjin, kështu që ajo është një qështje esenciale që neve kemi pasur ndermarrje që ju bie shitja në treg ju bie profiti bordet marrin bonuse të shumta dhe prap ky bord është rizgjedh, jo që nuk janë thirrur në përgjegjësi por një numer i tyre i madh prap janë rizgjedh dhe prap ata tash në nguti në kohën kur Qeveria ka qenë në njëfrar vakumi shpallin konkurse dy ndermarrje publike qoftë për drejtorë pa ja dhënë publikut informatën e caktuar lidhur me performancën. Ata duhet ta dinë që kanë përgjegjësi jo vetëm për me rahatuar vehtën por është përgjegjësi elementare e bordeve që ta rrisin vlerën e aseteve ta rritin shitjen dhe ti përmirsojnë performancën. Ndersa sa i përket procedurave nëpër borde për zgjedhje të kryeshefave sigurisht që edhe ato përmbajnë brenga mirëpo jo ne nguti, unë kam ndëgjuar në Infrakos sjam i sigurt se a ishte ajo, kur u shpall konkursi ku ata shpejtë e shpejtë e kanë shpallë konkursin në PTK e kanë shkarku drejtorin në kohën e vakumit Institucional, ata kanë arsye sigurisht unë nuk po i vie në pyetje, por publiku lidhur me këtë nuk është njohtuar. Tash ata e kanë zgjedhur një ushtrues detyre ai ka filluar me punë që fatbardhësisht kjo 3G, 4G u gëzova kur hyni PTK –ja në to por tani përsëri janë ngut për me zgjedh të riun dhe janë disa gjëra që neve nuk mund të përziemi aty sigurisht por si njëzë me përgjegjësi duhet ti evidentojmë si probleme dhe duhet ti shohim si do të shkojnë gjerat përpara sepse në fund qytetarët do të kërkojnë përgjegjësi nga Qeveria dhe Kuvendi, dhe ne duhet ta shiqojmë se si duhet ti dimenzionojmë këto probleme, sepse në fund shumë qytetar kërkojnë prej neve një performancë më të mirë të ndërmarrjeve publike edhe një ofrim më të mirë të shërbimeve. Kjo është çështja që unë bësojë që këtu nuk kemi dilema anjëri nga ne por duhet të punojmë sëbashku edhe me opozitën ku për sotë më vie shumë keq që nuk e kemi prezente pa marrëparasysh skish qenë aq problem që kolegët tonë të jenë këtu sepse jashtë sigurisht që ka mjaftë, të jenë këtu për të na ndihmuar sëbashku me Ministrinë mbasi është prezent ti detektojmë problemet për arsye që ata kanë pasur dëshirë që ta ftojme ministrin. Mandej ja kaloi fjalën deputetëve për pyetje dhe diskutime.

Deputeti Blerim Grainca – Përhëndetje për të gjithë pjesëmarrësit e falënderoj ministrin dhe ekipin e tij për kohën që kanë gjetur që të jenë sot present në këtë takim të Komisionit. Ai tha se brenga ime dhe e gjithë anëtarëve të komisionit këtu do të doja kryesisht të theksoja lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike, sepse kemi një lloj të një paqartësie në opinionin rreth asaj që kush kujtë i raporton dhe si arrihet deri tek niveli i përgjegjësisë. Performanca e një kompanie të gjithë e dijme se matet me kualifikimin e shërbimeve të cilat ajo i ofron qytetarëve dhe nëse i referohemi kualitetit, kualitetet të cilat sot ofrohen nga ndërmarrjet publike qoftë ato të nivelit qëndror apo nivelit lokal mendojë se mund të jenë më të mira këtë po e themë sepse është e vërtetë se po ashtu siq e thatë dhe ju z.Ministër ku është rritur sasia e ujit mirëpo janë rritë edhe problemet me të cilat ballafaqohen edhe qytetarët në kuadër të shërbimeve që ofrojnë kompanitë e ujit, duke filluar nga faturimet të cilat nuk janë të sakta që janë paushalle në të shumtën e kohës këto kompani publike të ujit shpeshherë nuk i lexojnë orët shpeshherë qytetarët paguajnë vlera të cilat nuk janë reale dhe paguajnë ujin që ndoshta nuk e kanë shpenzuar fare. E njëjta gjë vlenë edhe në sektorin e energjisë, unë e di që nuk interferonë në punën e Ministrisë së juaj por i njejtë problem është edhe aty, edhe tek ndërmarrjet që bëjnë grumbullimin e mbeturinave dhe shërbimeve të cilat mirren me pastrimin e qytetit . Do të thotë që këto kompani sheshherë faturojnë shërbime të cilat nuk i kanë kryer dhe qytetarët paguajnë një taksë e cila për të cilën ata nuk kanë shpenzuar. Lidhur me bordet unë mendojë që ka qenë një rregull në të kaluarën që këto borde janë plotësuar kryesisht me militant partiak dhe me njerëz të cilët nuk i kanë kontribuar zhvillimit të kompanive publike dhe kjo ka ndikuar në zhvillimin e vet kompanisë dhe në uljen e aseteve. Nëse një kompani publike në momentin e zgjedhjes së bordit ka një vlerë të caktuar në treg dhe pas disa muajve ajo bie dhe unë mendoj se ky është treguesi më i mirë i shpjegimeve se ai bord duhet me shku te shpija dhe mos të kemi situatë siq na kanë bërë në të kaluarën kur disa raporte të kompanive publike apo të njesisë për monitorimin e kompanisë për ndërmarrje publike nuk kalojnë dhe askush nuk merr asnjë mas ndaj tyre pra ndaj këtyre bordeve, prandaj unë ju rekomandoj edhe Ministrisë edhe anëtarëve të Komisionit që bashkarisht ta rregullojmë çështjen e

përgjegjësisë së bordeve në mënyrë që këto borde të kenë një kualitet të performancës dhe mbi të gjitha tash kur janë hapur konkurset të zgjidhen njerzit të cilët kanë kualitete profesionale dhe njëkosisht kualitete etike dhe morale për punën të cilën e bëjnë. Në fushat tjera siq e përmendi Ministër siq është Telekomit dhe teknologjia informatike unë mendoj që janë dy fusha ku Kosova ka resurse të mjaftueshme dhe siq e dini deri tani teknologjia informatike është njëra prej mundësive më të mëdha që ofron tregu dhe ne kemi të gjitha kapacitetet sepse kemi një moshë të re të popullatës dhe një popullatë e cila është kualitative në kuptimin profesional të përgaditur për të hyrë në këtë treg, pra teknologjia informatikë është biznesi nr. një në Botë dhe mendoj që jo vetëm të diskutohet sipërfaqësisht Ministër në planin tuaj dhe në programin qeverisës por duhet të jetë njëra ndër top prioritetet e kësaj Qeverie po ashtu mendoj që kjo Qeveri duhet ta shqyrtojë mundësinë e futjes së I-Gavërnment apo të qeverisjes elektronike në të gjitha Insitucionet e Republikës së Kosovës si një mundësi për përmirsimin e shërbimeve sepse duke e futur qeverisjen elektronike e ulum koston e shpenzimeve dhe njëkosisht ulin performancën edhe të gjitha shërbimeve qeveritare por edhe të vet kompanive publike. Unë mendoj që Komisioni ka gadishmëri që të bashkpunojë ngushtë me z.Ministër për ti zgjedhur këto probleme prandaj edhe unë ju ofroj një bashkpunim të ngushtë në mënyrë që ti tejkalojmë të gjitha problemet dhe besoj që shumë shpejtë edhe opozita do të na bashkohet dhe kësajsoji bashkarisht do t'ja dalim.

Deputeti Fatmir Rexhepi – falemnderit kryetar, përshëndetje për të gjithë, mendoj që tranzicioni ekonomik bashk me atë pjesën politike që thuajse çdo ditë jemi marrë në Parlament, Insitucione kudo tjetër ka qenë një test i vështirë për të gjitha kuadrat dhe Insitucionet e vendit në tërë këtë kohë 14 vjeqare prej kur është në mundësitë tona që të kemi zhvilluar aso politika apo aso strategji që kishte me ndiku në jetën ekonomike dhe zhvillimin e këtij vendi. Unë mendoj që testin në këtë plan nuk e kemi dhënë as si kuadra as si Insitucione nuk e kam për kritik apo marketing por realisht me shiquar nga viti 2000 për aq sa kemi pasur kompetenca deri në shpalljen e pavarësisë dhe nga pavarësia e deri në këtë fazë dhe mendoj që nëse kemi rënë në provim sinqerisht si Insitucione kemi rënë me gabime apo nga mos njohja e këtij tranzicioni dhe kjo ngecje e madhe ekonomike na ka sjellë në këtë pozicion jo të favorshum ekonomik të vendit ku nuk u krijuan mundësitë që të garantojmë perspektiva më të mira për zhvillimin dhe për investimet që ju duhen vendit. Si do që të jetë kjo që ndëgjuam sotë nga z.Ministër unë mendoj që është një sfidë e madhe po ashtu për Ministrin jo vetëm sot por edhe më heret janë bërë përpjekje që të ketë një strategji për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Unë i kam lexuar disa herë ato drafte, ato të cilat kanë qenë, por asnjëherë nuk kemi mundur që ti zyrtarizojmë në parlament ashtu së paku une e di, që ato të kenë marrë një karakter dhe ashtu të kenë përfunduar në mënyrë që të jenë një paketë e objektivave kryesore që nga duhet të ecë zhvillimi ekonomik i këtij vendi. Në qoftë se ka mundësi që ajo strategji sërish të ripërpunohet, sërish të zhvillohet sëbashku me kuadrat do të ishte mirë dhe me prioritet Ministria ta ketë edhe këtë çështje në mënyrë që të kompletohet edhe të vie edhe para Qeverisë edhe para Parlamentit në mënyrë që të dihet për çka mund të zhvillohet mënyra se si mund të zhvillohet prioritetet katër vjeqare afat mesme dhe afat shkrutëra për Kosovën për të gjitha sektorët që kanë ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit. Çështja të cilën e ngritët këtu dhe e thatë lidhur me ndërmarrjet publike që janë në menaxhim qoftë të Qeverisë apo në nivelin komunal duhet të provohet të mirren praktikat ma të mira të kësaj qeverisjeje dhe të shkojnë ato në rritje me performancë sa më të mirë, qoftë me ndërmarrjet që kanë të bëjnë me ngrohje apo sidomos me i kushtuar rëndësi pjesës tjetër të cilën e përmendi Ministri trajtimin e ujrave të zeza sepse nuk ka Komunë në Kosovë e cila nuk e ka këtë hall, pra këtu duhet të zhvillohet një parteneritet shumë i fuqishëm, me investitorët por edhe me donatorët edhe komunat në mënyrë që të ketë një strategji për të gjitha komunat se ku mund të zgjidhet apo si mund të zgjidhen këto probleme gradualisht sepse këto janë investime shumë të mëdha të cilat komunat nuk kanë mundësi nga buxhetet vetanake ti realizojnë bashkë me furnizimin me ujë apo me mbrojtjen e ambientit dhe cilado qofshin si problem i këtyre Insitucioneve publike. Ajo që është potencu dhe që do të duhej të ishte një prioritet i kësaj është

çështja e strategjisë për PTK-në që janë dhënë disa varijante qoftë ajo që është dhënë ma herët kur kemi biseduar jo në këtë mandate por në mandatin gjatë 2010 dhe më herët qoftë në këtë mandate, mendoj që me të drejtë e keni shtuar këtë të shikohet rivlersimi i saj dhe të mendohet mirë se çka duhet bërë me PTK-në si ndërmarrje publike drejtë privatizimit dhe atëher kur kemi kohë do të ulemi dhe të bisedojmë se cili do të ishte variant ma i mirë dhe më i arsyeshmi për të. Ajo që është një notë negative për krejtë neve gjitha qeveritë pa përjashtim është sektori i energjisë për të cilin kemi folur shumë kemi debatuar shumë kemi mbajtur me dhjetra e qindra konferenca gjatë gjitha mandateve por me krejtë këto resurse që i kemi në sektorin e energjisë nuk arritëm që ta ndërtojmë një termocentral as atë që u premto pre dy mijë Megavat as tjetra prej një mijë e njëqind por as per 300 Megavat që është ma e vogla, pra iku koha, ikën mandatet thjesht sa vitet po bohen kur kemi filluar nga viti 2004 thujse 10 vite vetëm fjalë, fjalë dhe asnjë punë konkrete nuk kisha dashtë që edhe ky mandate të fillojë apo së paku të mos fillojë pa një partneritet dhe investime në këtë fushë sepse edhe ashtu kemi mbetur mbrapa shumë qoftë ajo 600 apo plus 600 apo si do që të mendohet që është më mirë por të realizohet e jo të mbetet çështje vetëm për të mbajtur konferenca. Çështja tjetër është lidhur me P/Ligjin që e kemi biseduar shumë që u bë edhe temë politike edhe u bë temë e ndishme Ligji për ndërmarrjet publike plotësim ndryshimi besoj që ato do të kem mundësi ta draftojmë ta ndryshojmë në ato pjesë që u tha por që ka shumë rëndësi të shifet sepse ato prona ato ndërmarrje shoqërore të gjitha komunat të cilat kanë mbetë ato të cilat janë mbetë pa u privatizu të shikohet që ato realisht pajtohemi që sa ma shpejtë të merren në mënyrë që të ju ipet një mundësi partneriteti zhvillimit të komunave jo për me i marrë tokat e ndërmarrjeve për me ndërtu banesa por ato duhet të shfrytëzohen për infrastrukturë publike edhe gjithqka tjetër që i duhet zhvillimit të komunës për nevoja të qytetarëve dhe kjo sa më shpejtë që të bëhet aq më mirë është. Për Trepçën unë nuk kisha folë më shumë t'ia lëmë kohës kur të vie momenti të ulemi dhe të bisedojmë singlerisht ashtu siq duhet bashkë me këtë pjesë që i takon Ligjit edhe pjesën tjetër pra Ligjin e veçantë për Trepçën në mënyrë që ti mbyllim këto dhe të mos na mbesim vetëm fjalë e mandej të na dalin problem, prandaj po e mbylli këtu sepse të gjitha këto punë Ministria e juaj që ju e drejtoni për mendimin tim është njëra ndër Ministrinë kryesore që jep kahje zhvillimit të vendit, ato që i planifikoni ju, për neve në Komision kemi mundësi ti debatojmë ti japim udhën ti përkrahim ti mbështesim dhe realisht të kemi një strategji të zhvillimit të këtij vendi për të gjitha këta sektorë sepse kjo është shumë me rëndësi për neve prandaj edhe puna e bordeve e cila u përmend që sa më shumë të mundohemi këto gjëra ti përfundojmë në mënyrë që njerzit të punojnë menaxhojnë por edhe të jepet edhe llogaria për punën të cilën e bëjnë andaj do të keni përkrahjen e plotë në qoftëse këto punë do ti projektoni dhe do ti vendosni me rend dhe ti bisedojmë.

Deputeti Besim Beqaj, faleminderit kryetar, I nderar Ministër të nderuar deputet, përfaqësues të mediave. Tema e ndërmarrjeve publike është temë me interes të veçantë sepse shërbimet të cilat i ofrojnë shërbimet publike nuk mund ti ofrojë asnjë ndërmarrje tjetër. Shpeshëher janë shërbime të subvencionuara për shkak se shumëherë ato nuk mund ti mbulojnë shpenzimet e veta prandaj kisha dashur kur të flasim për performancën e ndërmarrjeve publike të keni parasysh që janë ndërmarrje të cilat kanë obligime në raport me qytetarët por që nganjëher performancat e tyre financiare nuk është krejtësisht në duart e tyre sepse janë edhe rrjetet dhe mekanizmat e tjerë të cilët i privojnë ata nga shërbimet e plota, prandaj kur flasim për ndërmarrjet publike besoj që duhet ti kemi dy gjera parasysh performancën financiare dhe performancën menaxheriale. Performanca financiare, unë në bazë të këtij dokumenti që e pashë tani tash përshkurtazi të GAP-it por edhe nga përvoja ime paraprake që e kamë pasur duhet të themi që ndërmarrjet publike në mardhënie të vazhdueshme kanë pasur përmirësim të performancës financiare dhe përmirsim të performancës menaxheriale, nuk është ajo që neve e presim por gjithësesi duhet ta kemi parasysh që këto ndërmarrje nuk janë diqka që mund të rregullohen me një vendim, të kuptohemi këtu as me një aktë administrative por kërkonë një performancë të përmirësuar sipas afateve kohore të cialat menaxhmenti i parashef. Unë e përgëzoj Ministrin për hyrejn shumë të shpejtë në rrejdha

të detalizuara të punës së Ministrisë së Zhvillimit ekonomik. Janë disa çështje në të cilat kamë shqetësim të kahmotshëm dhe janë shqetësime të cilat duhen të adresohen besoj që është me urgjencë çështja e bordeve të ndërmarrjeve publike është pika ku duhet të fillojmë, është konkursi i cili është hapur shpresojë që duhet të realizohet shumë shpejtë dhe të kenë parasysh kriteret profesionale të cilat do ta udhëheqin bordin dhe që ato borde pastaj kanë kompetencën e zgjedhjes së drejtorëve të ndërmarrjeve publike. Duhet të kuptojmë që ndërmarrjet publike janë themeluar me Ligj mbi ndërmarrjet publike dhe kompetencat janë realativisht të qartësuar edhe të bordeve edhe të obligimeve të bordeve lidhur me menaxhimin e ndërmarrjes publike respektivisht me zgjedhjen e bordit të drejtorëve është mirë që ne të diskutojmë për zgjedhjet e drejtorëve të bordit për cilësitë e tyre por duhet që as Qeveria nuk e ka atë të drejtë si akcionar në mënyrë të drejtë perdrejtë të merret me zgjedhje por kanë bordet e drejtorëve të cilat janë reflektim i interesit të aksionarit në raport me ndërmarrjen publike. Pra përgjegjësia është koga e çartë ne kërkojmë në qoftë se ka nevojë për qfardo lloj amendamenti që Ministria do ta fillojë ne jemi të gatshëm për ti ndihmuar por besojë që më shumë ka të bëjë me zbatimin dhe implementimin e Ligjit se sa me ndryshimet të cialt do ta përmirsojë, pra edhe kur flasim për performancën përmirsimi i performancës në ndërmarrjet publike është gradual. Ju e përmendet ujin, të kuptohemi që cilësia e ujit furnizimi i ujit humbjet e ujit janë në raport me të kaluarën shumë më mirë se si kanë qenë dhe unë shohë që shumë shpesh kemi raporte jo korrekte në publik sa perket furnizimit të ujit. Humbjeve të cilat shkaktohen dhe merret kaq humbet 50% apo kaq humbet në raport me ndërmarrjet kur bëjmë krahasime duhet ti marrim edhe krahasimet me vende të tjera, dhe me investimet të cilat janë bërë të cilat mund ta mundësojnë ndërmarrjen se si mi paranadalu ato humbje, pra duhet të themë që humbjet e ujit të ndërmarrjet publike tek ne nuk janë fortë larg në raport me vendet e rajonit edhe nuk janë fortë largë edhe me vendet të cilat kanë aspiru në bashkimin evropian dhe janë anëtarë pra me Krocinë. Këto sigurisht Ministri dhe drejtori mund të na japin informacione më të sakta por që humbjet e ujit, humbje teknike jo humbjet komerciale pra jo vjedhje, humbjet teknike janë përafërsisht të barabarta. U trajtua çështja e themelimit të ndërmarrjeve lokale d.m.th të ndërmarrjeve publike, besoj që është një diskrepancë e madhe në mes të dëshirave të cilat i kanë kryetarët e komunave, mundësisë së tyre financiare dhe obligimit që ka Ministria në raport me ndërmarrjet publike respektivisht komisioni ndërmarrës për ndërmarrjet publike, pse ekziston kjo diskrepancë?, sepse kryetarët të cilët ballafaqohen në mënyrë të drejtëpërdrejt me problemin e qytetarëve e shohim problemin vetëm nga këndvështrimi i afatshkurt, ditor dhe jo në atë afatgjatë, pra kryesisht ka pasur kërkesa dhe ka kërkesa dhe do të ketë kërkesa që secila komunë të ketë ndërmarrje të veta publike por mos ti merr obligimet. Ne kur e kemi amendamentin më heret Ligjin për ndërmarrjet publike kemi pasur kërkesa nga asociacioni i komunave dhe nga komunat që stacionet e autobusave që e kemi shëndrru në ndërmarrje publike të jenë edhe në nivel lokal edhe ka qenë gabim në publikisht e kamë thënë edhe asociacioneve të komunave që po boni një gabim të madhë dhe po e qoni një detyrë drejt obligimeve financiare të cilat do ti ketë komuna në të ardhmën sepse nuk kanë fuqi financiare për ti bartur sepse kjo po ju kthehet shumë keq sepse nga ministria e financave shpesh vinë ndalesa dhe bllokime të llojeve të ndryshme të llogarive për shkak të obligimeve procedurave gjyqësore të cialt i kanë përmes tenderuesve, pra duhet ta kemi parasysh që themelimi i ndërmarrjeve publike të jetë në kriteret ekstreme të ashpëra dhe Ligji e thotë shumë qartë se thotë mund të themelohet një ndërmarrje në rastë se Kuvendi e merrë një vendim por duhet me pasur arsyeshmëri financiare. Pra kriteri është shumë i qartë se arsyeshmëria financiare në periudha afatgjate a mundësonë themelimin e një ndërmarrje. Problemi ka qenë tek ndërmarrjet e ujit dhe është sepse komunat kanë dëshirë që secila ta ketë atë mbizotrimin e drejtëpërdrejtë por rreziku i themelimeve të ndërmarrjeve pastaj do të bëhet me kushtëzime që komunat do ti bëjnë në raport me qytetarët për pagimin e obligimeve të cilët ata e kanë të faturuar. Pra edhe këtu nëse vonohemi, për ti shtrenguar kriteret e keni përkrahjen tonë por ju luetmi që të keni kujdes në themelimin e ndërmarrjeve të reja sepse unë mendoj që nuk është në interes as të qytetarëve por është interesi momental për ndonjë punsim por që nuk janë gjëra shumë të mëdha. Tek njësia për implementim për krijim të politikave dhe për monitorim është

njësi e cila ka për obligim monitorimin por nga këndështrimi i performancës menaxheriale nuk ka autorizime të drejtëpërdrejta në ndërmarrje pra kur falsim për performancën Ministri e tha shumë qartë, performanca e këtyre ndërmarrjeve dhe raportin të cilët këta e sjellin tek Kuvendi është refleksion i raportit të auditorëve të brendshëm, auditorëve të jashtëm dhe ato të dhënat të cilat na në një kohë i kemi marrë nga një organizat zvicerrane që na ka ndihmuar për harmonizimin e atyre raporteve. Raporti çka duhet të jetë është që duhet të jetë konsistent me metodologjinë dhe përcaktimin e krahasimit me vite dhe kjo e jepë një pasqyrë të pastër por duhet të kuptohet që Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka përgjegjësi, unë këte e kamë thënë shumë herë edhe sa kam qenë ministër por tash mund ta themë edhe shumë më lirshëm dhe kuptohet se nuk ka kompetencë të drejtëpërdrejtë në menaxhimin e ndërmarrjeve publike as në përgjegjësi për mos funksionimin apo funksionimin e drejtëpërdrejtë, për shkak se zgjedhja e anëtarëve të bordit bëhet nga zyrja e Kryeministrit nuk është kompetencë e Ministrisë është kompetencë e nivelit qendror zgjedhja e bordeve dhe profesionalizimi që duhet të jetë tek bordet. Nëse flasim për energjinë edhe këtu besojë që duhet të ndahen obligimet të cilat i ka Ministria e cila është krijuese e politikave, ndërsa zbatimin e politikave dhe strategjisë së energjisë e kanë institucionet e pavarura në këtë rastë është rregullatori dhe operatorët ekonomik të cilët janë drejtëpërdrejtë të involvuar në këtë proces, pra Ministria mund të ftohet për përgjegjësi a për raportim për çështjet të politikave në fushën e sektorit të energjisë edhe nëpër ndërmarrje publike. Sa i përket Telekomunikacionit dhe përzgjedhjes së drejtorave që u përmend nga ana e Kryetarit besoj që këto gjëra ju duhet ti mbani nën përkujdesje por gjithmon ta ruajmë atë diskrecionin e bordeve respektivisht bazës ligjore për ndërhyrje sepse ne nuk kemi të drejtë të ndërhyjmë në asnjë rrethanë në procese të tilla. U përmend edhe trajtimi i ujrave të zeza Telekomit , janë projekte të cilat janë ka zhvillohen në ndërmarrjet tona publike në bashkpunim me donatorët që janë gjerman, zviceran dhe suedez që janë kryesisht të koncentruar në atë pikë sigurisht projekcionet të cilat i ka bërë edhe komisioni evropian për trajtimin e ujrave të zeza nëpër qytete tjera të Kosovës do të jenë bazë e mirë që jo të hyjnë dhe të komunikojmë edhe me donatorët e tjerë. Dhe së fundi çështja e rivlersimit të strategjisë të PTK-së mendoj që është një proces i cili ka filluar më heret është diskutu dhe është mirë që edhe një herë me marr vendimin. Atëher ju është kthyer Parlamentit për një rivlersim dhe atëher Parlamenti le ta rivlereson dhe le të vendos që në çfarë rruge le të shkon. Ju faliminderit shumë, por edhe një herë e përgëzoj Ministrin për një raportim ekzaktë dhe të shkëlqyeshëm.

Raif Qela, që mos t'i përsërisë fjalët kolegëve deputet, unë do të ndalem në tri çështje shkurtimisht. Para së gjithash lidhur me ndërmarrjen publike Posta dhe Telekomit i Kosovës edhe nga kjo analizë e institutit GAP shihet qartë se ka rënie të indikatorëve financiar dhe të tregut për PTK-në. Pa dyshim se njera prej shkakëtarëve kryesorë të kësaj është se Post Telekomit i Kosovës është kompania e vetme publike e cila ka konkurrencë legale edhe ilegale dhe si e tillë është në raportë të pa barabartë më të tjerat, pse po them kështu..sepse ka së paku 30(tridhjetë) ASP-i të cilat veprojnë në mënyrë jo legale, sepse Ligji i Prokorimit është shumë i pa favorshëm për Post Telekomin dhe është kompania e vetme publike e cila duke u ndodhur në një mjedis të tillë në të cilin ka pengesa shumë të mëdha nga fusha e prokorimit rrejdhimisht shpesh herë ndodhet para situatave teper të vështira që të mund të jetë në hapë me kohën, shpeshë herë i duhen procedura të përsheptuara që prokurimi të mund që ta zëjë hapin p.sh ka pasur pengesa shumë të mëdha lidhur edhe me 3G dhe 4G që e përmendi kryetari i Komisionit, por edhe për shumë çështje të tjera. Prandaj mendoj që është më se e domosdoshme, padysim që strategjia që do ta bëjë Qeveria, është e mirëseardhur mirëpo para se të marrë vendim se kah po don ta qojë PTK është mirë që të ketë qoftë Ligj të posaqëm për PTK-në qoftë të bëjë lehtësira në fushën e prokorimit përveq çështjeve tjera që u thanë që duhet të mbikqyret bordi i drejtorëve të PTK-së. Kjo është çështja sa i përket Telekomit të Kosovës. Çështja tjetër është lidhur me kombinatin Trepça dhe me Ligjin për Ndërmarrjet Publike por këtu do të flas vetëm kalimthi, pa dyshim që këtu Qeveria, Ministria përkatëse për Zhvillim Ekonomik edhe Kuvendi edhe ky Komision kanë qenë në krye të detyrës sa i përket faktit që të mos e lejojmë ndërmarrjen Trepça të shkojë në

likuidim. Po të mos ishin hapat e shpejtë të ndërmarrë Trepça nga 2(dy) shkurti në bazë të vendimit të dhomës së posaqme të gjykatës supreme të aktvendimit do të shkonte në likuidim. Hapat e ndërmarr pa dyshim janë hapa të duhur edhe për këtë të gjitha institucionet duhet të jenë të knaqura me punën që kanë bërë, pa dyshim që pjesa tjetër e punës qëndron që kombinatin Trepça ta nxjerrim nga kjo gjendje agonie në të cilën është ndodhur tash e 15-16 vjet, ta nxjerrim nga kthetrat e AKP-se , gjykatës supreme dhe të dhomës së posaqme mendoj se është detyrë e rëndësishme i është shtuar afati për rrezikun për likuidimin edhe për 21 muajë të tjerë por ai afat vjen shpejtë prandaj besojë që edhe Ministri por edhe Qeveria këtë do ta ketë parasysh edhe sa më shpejtë ta procedojë qoftë Ligjin për ndërmarrjet publike qoftë Ligj të posaqëm për Trepçën në mënyrë që çështja e Trepçës të hyjë në binar në mënyrë që Trepça të riktheht në një forcë të madhë të zhvillimit ekonomik të Kosovës, prandaj do të kisha pasur dëshirë ti bëja pyetje Ministrës se a është planifikuar kur të ndërmerren hapa të tillë edhe pse unë jam shumë i sigurtë që nuk është aq akute sa që ka qenë para dy tri javësh. Çështja e tretë ka të bëjë me kodin telefonik edhe pse ndoshta drejtëpërsëdrejti nuk lidhet me këtë rend të sotëm dite e dim mirfillin se prej përfundimit të luftës e deri më tani në bazë të vlersimit ekspertëve Kosova ka humbur së paku 500 milion euro ndoshta edhe deri në 800 milion euro në mungesë të kodit të vet telefonik. Dy deputet nga perbërja për lëvizjen për bashkim e kanë marrë një iniciativë dhe prej tyre ka rrjedhur një rezultat që në mungesë të kodit të vet telefonik Kosova ta shfrytëzojë kodin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë që së paku një pjesë të përfitimeve të mëdha që vijnë nga kodi telefonik të shfrytëzojë, ky rezultat është mbetur në sirtar, përkundër kësaj hapat e ndërmarrë të tjerë pas bisedimeve me Serbinë kanë rezultuar se do të merret kod i veçantë telefonik megjithatë kjo çështje po zvarritet, edhe pse nuk janë përfitimet e mëdha enorme siq kanë qenë pas luftës megjithatë Kosova vazhdon të humbë diku rreth 20 milion euro në vit në mungesë të kodit telefonik është mirë që të bëhet përpjekje që kjo çështje të përshpejtohet në mënyrë që të ketë përfitime prej kodit të vet telefonik apo të gjejë zgjidhje alternative derisa ta marrim në kodin. Ju faliminderit.

Sala Berisha Shala, faleminderit kryetar përshendetje Ministër dhe bashkëpunëtorëve të tijë, kolegëve deputet, mediave , është keq që nuk janë sot me ne edhe kolegët deputet nga opozita ku unë mendoj që ata e kanë vendin këtu në Institucione për të bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme për të mirën e qytetarëve sido qoftë e dinë ata më mirë. Unë çka do të them tash mund ta them në formë të ndryshme por mund edhe të përsëritem nga kolegët e mi por është i mirëseardhur edhe ky informacion edhe kjo pikë e rendit të ditës ku mendoj fushëveprimtaria e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik është më e gjërë se kjo çka e kemi ftuar në theksë të veçantë për Ndërmarrjet Publike dhe Telekominikacion. Është mirë që në strategjinë legjislative të këtijë viti në Kuvend Qeveria ka sjellë plotësim ndryshimin e ligjit të ndërmarrjeve publike por mendoj që ndoshta duhet me ndërhy edhe në nene të tjera e jo vetëm aty ku parashihet çka të jetë pjesë e ndërmarrjeve publike që rregullohet me këtë Ligj. Ajo që unë mendoj që Ministria e Zhvillimit Ekonomik gjithësesi duhet të kushtojë shumë rëndësi sektorit të energjisë që dikund e përmendi dikush nga kolegët deputet që sektori i energjisë është i lidhur ngusht me sektorin e minierave kryesisht me mineralet e linjtit mendoj që edhe mineraleve tjera që janë lidhur me Trepçën që tani e kemi në një pozicion ashtu pezull mbas kësaj pikë të rendit të ditës ne e kemi si komision ta shqyrtojmë edhe planin e punës së komisionit që gjithësesi po shfrytëzojë rastin ta njohtoj edhe Ministrin këtu që shumicën e Ligjeve që ka në planin e punës komisioni ynë vijnë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dikund janë 8(tetë) prej tyre të Ligjeve të cilat i ka në shqyrtim. Unë kam menduar që sotë me shfrytëzuar rastin në këtë pikë me propozu komisioni që ne ta marrim nismën vetë si komision parlamentar për P/Ligjin për Trepçën, procedurat janë më të shkurta kur nismat janë nga Kuvendi unë mendoj që kjo është vetëm një e mirë edhe pse e përmendi edhe kolegu që neve e dimë shumë mirë që Ligji që u miratua javën e kaluar në procedurë të përshpejtimit është shty afati i likuidimit por sido qoftë nuk duhet të jemi edhe aq komod dhe të presim që të vie nga Qeveria drafti për Trepçën. Unë kam menduar që në kuadër të Planit të Punës të propozojë komisionit në qoftë se do të gjejë përkrahje me inicu edhe Ligjin

për Siguri në mbrojtjen në punë në miniera i mungon Kosovës ky Ligj, duke e ditur se ne e kemi KEK-un e cila është një ndërmarrje publike të cilin e monitoroni direkt por e mengjoni indirekt është edhe Trepça dhe Miniera tjera të vogla besoj që ne jemi këtu dhe duhet të bashkpunojmë shumë ngusht me juve. Tjetër kërkes që kam është mirë që nganjëher të shfrytëzohet mundësit që edhe deputetët të marrin pjesë në ato konferenca në mënyrë që të familjarizohemi me materien dhe ta kemi ma let me format e bashkpunimit lidhur me të gjitha çështjet tjera që lidhen me fushëveprimtarinë e komisionit si dhe me fushëveprimtarinë e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. Sa i përket Ndërmarrjeve Publike dihet që kriteret janë shumë mirë të përcaktuara por sido qoftë kjo përformancë e ndërmarrjeve publike edhe përceptimi tek qytetarët nuk është edhe aq pozitiv i menaxhimit dhe funksionimit të këtyre ndërmarrjeve publike por ne duhet ti bëjmë dallimet që sigurisht i keni edhe raportet cilat janë ato ndërmarrje publike që përformancën e kanë positive dhe cilat janë ato ndërmarrje publike që sigurisht sikur të ja kishim ndrruar statusin e tyre ndoshta do të kishin funksionuar më mirë se siq janë tani në të mirë të qytetarëve. Unë nuk ka më diqka tjetër të shtojë. Ju faliminderit shumë prej jush për informacionet shpresojë në punën dhe bashkëpunimin e juaj të mëtutjeshëm.

Kryetari Muhamet Mustafa, faliminderit të gjithëve, dhe para se të filloj Ministri të na jap komente unë vetëm për njohtim dhe për opinionet e gazetarëve do të presim edhe raportin e njësisë ku ende nuk e kemi diskutu 2013 shumë shpejtë do të vie raporti i vitit 2014 ju kisha lutur që mos të vonohet sepse unë mendoj që ne kemi nevojë që të shohim pak metodologjinë. Ajo metodologji që ju e perdorni a na jep pasqyrën e plotë të përformancës së bordeve dhe ndërmarrjeve. Për Kuvendin për Qeverinë për neve pajtohemi çka tha z.Beqaj, në bordet ne duhet të shohim a kemi aty indikator të cilët e matin përgjegjësinë e bordeve sepse është mirë që ti objektivizojmë sa më shumë, kur flasim të flasim me argument por prej një pasqyre që sote e kemi analizën e GAP-it ku sigurisht edhe nga ju e keni marrë d.m.mth prej 17(shtatëmbdhjet) ndërmarrjeve që shtatë janë me humje kanë humbje. PTK-ja nuk ka humbje por në vitin 2013 të gjithë indikatorët janë përkeqësuar dhe mu për këtë unë e ceka problemin e bordit aty, problemin e zgjedhjeve të drejtorit dhe janë çështje që ne nuk interferojmë por nuk e di se kushë është kompetentë me pa rregullsinë dhe procedurat ligjore aty që janë bërë. Në këtë drejtim duhet të shihen dhe për këtë, unë ftojë organet kompetente me pa Ligjin edhe të TERMOKOSI edhe të PTK-ja mi pa procedurat a janë me Ligjë apo nuk janë. KEK-u fatëbardhësisht është në një situatë që diku që në të gjitha thuajse indikatorët ka përmirësim por është edhe një tjetër element ku neve pak e kemi analizë. Në të ardhmën duhet të shohim p.sh për katër vitet në periudhën 2009-2013 kemi subvencione dhe 201 milion dhe investime 54 milion dhe ne nuk kemi një informat kthyesë si janë raportu si janë përdorur këto subvencione cili ka qenë kriteri i tyre sigurisht në të ardhmën Qeveria duhet me i intervistë por neve duhet ta vendosim një rregull që duhet të jetë raporti në publik në Ministri se çka është përfitu me këto investime, në këtë drejtim mendoj se ishte një bisedë shumë shumë e dobishme për komisionin besoj që edhe për Ministrin. Ne i dëshirojmë Ministrin shumë sukses e inkurajojmë Ministrinë ku sigurisht në mbledhjen e ardhëshme mund të pres pyetje më të vështira por nvarret prej përformancës ku besoj që me këtë elan dhe me këtë vullnet do të kemi një atmosferë siç e patëm sotë sepse qëllimi ynë është i përbashkët por sot e ka pasur atmosferën më të lirshme sepse nuk ka qenë prezente opozita mirëpo unë po them se sa i përket interesit për ndërmarrjet publike edhe deputetët e opozitës do të jenë aty që të monitorojnë dhe ti ndihmojnë Ministrisë atë që duhet të ndihmojnë por gjithëherë duhet ta kenë parasysh edhe Ministrat që Kuvendi ka një përgjegjësi supreme të ruajtjes së pasurisë dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtimë puna e parë që do mund ti nxjerrë për ne dhe interesin tonë të përbashkët është dhe kisha dashtur të them që ju sëbashku me administratën tonë edhe me ekspertët të shohim këtë Ligjin për Ndërmarrjet Publike ne ende nuk e kemi hartu Ligjin mbi Trepçën unë me qëllim nuk vura theks shumë, d.m.th Ligji mbi Plotësimin dhe Ndryshimin është në procedurë, ne kemi paraparë kur ta diskutojmë planin e punës së Komisionit ta mbajmë një Dëgjim Publik pastaj leximin e parë në Komision në Kuvend pastaj leximi i dytë d.m.th shkon me një kujdes shumë të shtuar nuk do të veprohet ma me ndonjë lloj

paniku apo me nguti. Unë ju shpreh mirnjohje edhe Ministrisë edhe Qeverisë edhe deputetëve që d.m.th me datën 19 të këtijë muaji ne e kemi stopuar mundësinë e likuidimit kështu që do të fusim në planë pune orientimisht edhe Ligjin për Trepçën edhe ju duhet të shifni që Ligjin për Trepçën e shoqëron studimi i Trepçës fizibilitetit pra duhet ta shofim një periudh kur këte duhet ta bisedojmë pra na mbetet pra kur ta shofim përafërsisht se kur do të vie ai Ligj duke e dhënë një kohë të mjaftueshme por jo kohë që e prolongon atë çështje sepse çështja është aty. Strategjitë i përmendëm pra duhet ta kemi strategjinë për PTK-në pra duhet ta kemi dhe strategjinë për Eenergji ku them se edhe kjo është një dukumentë mjaftë me rëndësi paraprakisht duhet ta shofim edhe Ligjin për Miniera se a është praktik për investorët dhe se a e mbronë interesin publik por janë shumë gjëra që janë shumë të rëndësishme ku z.Qela e përmendi kodin ku mendoj që është çështje shumë e rëndësishme me pa që ku ka mbet ajo çështje qysh do të shkojë me biseda simbas znj.Tahiri kjo punë është dashur të kryhet se janë pajtuar njerzit dhe ne nuk duhet të mos pajtojmë dhe duhet ta mbijamë vazhdimisht aktuale e tjera tjera. Faliminderit

Blerand Stavileci - Ministër, faliminderit, se unë mora edhe shënime edhe saktë janë 15 komente që i bëtë dhe unë po e shfrytëzoj mundësinë, me qenë se Shala e morri fjalën e fundit po shkojë prej përgjigjeve të pyetjeve nga fundi edhe diqka që ndoshta nuk u diskutua dhe mendoj se do të duhej të diskutohet ne sivjet i kemi 8(tetë) Ligje në fakt tash janë bërë 9(nëntë) për arsye se e kemi pasur Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre por mendoj që edhe Ligjet e tjera ku ju mendoni që janë në mandatin e juaj që mund ti iniconi ne jemi të pajtimin që pas një bisede konsultative të shohim se a është në të mirën tonë dhe pse jo edhe ato ti procedojmë. Pra e dijm që i kemi edhe 8(tëte) Ligje të tjera 4(katër) që lidhen me Energjinë, 1(një) është me ngohjen, 1(një) është me gazin natyror ,1(një) me digjitalizimet dhe 1(një) me ndërmarrjet publike. Po fillojë me ndërmarrjet publike që ka të bëjë me Trepçën dhe që besoj të gjithëve po na prekin këto çështje mendoj që Ligji për ndërmarrjet publike ku eshte e vërtet ashtu siq e tha edhe kryetari dhe të gjithë anëtarët ne është dashur të reagojmë në atë moment sepse ka qenë si i vetmi instrument i atyre ditëve të para të asaj emergjence që u kriju mbas vendimit të dhomës së veqantë të gjykatës supreme. Ndërkaq tash mendoj që nuk duhet nxituar dhe shumë qështje që u prekën dhe që lidhet me ndërmarrjet publike me bordet me përgjegjësinë e tyre, relacionet e atyre bordeve me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik me Kuvendin të precizohen më mirë, mendoj qe aty nuk duhet të nxitojmë por ti shohim edhe shumë çështje të tjera siq thuhet me një plumë të godasim më shumë zogjë pra kemi kohë dhe hapsirë për ti trjtuar këto probleme dhe mendojë që forma më e mirë është që të gjitha të përfshihen brenda plotësim ndryshimit të Ligjit për ndërmarrjet Publike edhe Ligjet të tjera të cilat ju do të diskutoni pastaj besoj që bashkarisht do ti trajtojmë. Po shkojë ndoshta në mënyrë të përmbledhur të përgjigjem por tashti për Trepçën mendoj që nuk do të flasim më tani ndoshta vetëm edhe një detal që u ngritë edhe që thatë që ju do ta iniconi tash duhet ta dimë që me Ligjin për riorganizimin plotësim ndryshimin pra neve kemi fituar me kohë tash edhe në programin e ri Qeveritar ku përkufizohen aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë institucionale të secilit mendoj që më e mira është që Zyra e Kryeministrit ta bëjë një grup punues sebashku me institucionet përkatëse në mënyr që ta shofim se si do të ecim tutje , pse ?, Sepse kështu siç e kemi tani në kuadrin ligjor përsëri mbetet që plani për riorganizim ta bëjë agjencia e privatizimit dhe ai pastaj do ti paraprinte një strategjie dhe ai pastaj një Ligji, Ligji pra është derivate i këtyre hapave dhe kjo është logjika institucionale e veprimeve që duhet ta pasojnë njëri tjetrin. Duhet ditur që, përderisa nuk është në madnatin tonë për ta nisur atë planë të riorganizimit atëher edhe dinamika e procesit ndryshonë sepse nuk jemi ne ata që e diktojmë dinamikën e procesit. Për ta ndryshu dhe përshpejtuar, por jo përshpejtim që ngutia të na sjell në momente apo në situata të pakëndshme por për ta bërë më të mirën mendoj që edhe këtu do të duhej një harmonizim në relacionin Kuvend dhe Qeveri, dhe besoj që kemi kohë dhe hapsir për ta diskutuar edhe këtë se cila është rruga më e mirë për ta bërë. Për sa i takon bordeve pajtohem plotësisht dhe mendojë që edhe kjo mund të zgjidhet nëpermjet Ligjit apo formave të ndryshme të tjera në mënyrë që secili ta merr përgjegjësinë e vetë për punën të cilën e bënë, qoftë për të mirë apo dhe për të keq pra

për ta bartur përgjegjesinë sepse ka një performancë negative qoftë ekonomike qoftë edhe në atë menaxherkale siç e tha edhe deputeti ish Ministri z.Beqaj sepse ndoshta më së miri edhe prej krejtë neve edhe ne fushën ekonomike edhe në fushën e financave i din problemet edhe nga njëra anë edhe nga ana tjetër. Për sa i takonë shërbimeve ate që e tha z.Grainca unë edhe kur e kamë takuar përsonalisht kompanien KRU të Prishtinës por edhe Ngrohtorën dhe të tjerët për sa i takonë shërbimeve, cilësisë por edhe faturimit. Sot në Botën moderne te ndermarrjet publike kemi të ashtuquajtur CENTRAL ALOCATION edhe WATER COST ALOCATION pra alokimi i shpenzimeve të ngrohjes qëndrore ose të ujit pra që nuk bëhen më me metodën e njësisë për vëllim ose për sipërfaqe por bëhet me metodën e shpenzimeve, pra aq sa ke shpenzuar aq edhe do të paguash që besoj është shumë e mirë dhe do ti eliminonte ato problem por prap ne mund ti inkurajojmë këto ndërmarrje publike dhe ti fusim në palnet e tyre për të ardhmën. Prishtina vetëm e ka përmendur në takimin që kemi qenë që nga fondet e veta, fondet e donatorëve ta shef mundësinë për të nisur projektet e tilla që besojë që do të ishin shumë të mira. Për sa i takon strategjisë kombëtare të zhvillimit ekonomik ju e dini tashmë që në zyrën e kryeminitrit e kemi një zyre të planifikimit strategjikë kemi pasur edhe një forumë që është quajtur këshilli kombëtar i zhvillimit ekonomik ne e dimë që si Ministri qoftë edhe si Ministria që unë e udhëheqi pavarësisht emrit të cilin e ka shumë shtylla të funksionimit nuk janë për ta kompletuar fotografinë e zhvillimit ekonomik dhe na duhet patjetër Ministria e Tregtisë dhe Industrisë , Financave dhe Infrastrukturës për ta kompletuar dhe e bujqësisë pra për ta kompletuar si të tërë por gjithmon me zyrën e planifikimit strategjikë në kuadër të ZKM-së dhe këtu besojë që do të duhej ta bëjmë një platformë të përbashkët të ketë një strukturë njerëzore që e udhëheq procesin dhe pastaj ta kemi një dokument por në të njëjtën kohë të punohet edhe diqka që ka qenë në kudër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik sistemi i integruar informatik i zhvillimit ekonomik ne dimë që sot kemi filluar t'i shofim raportet që dalim nga institucionet e ndryshme por që secila i merr për bazë ndoshta edhe ato studimet e veta edhe asnjëher qoftë ndonjë Ministër apo qoftë edhe ndonjë deputet apo ndonjë kryetar komune apo edhe një qytetar duhet me u shërby me burime të ndryshme andaj unë mendoj që sidomos treguesit makro ekonomik duhet ti dimë dhe duhet ti kemi të saktë dhe të mos kemi pra dualitete. Për sa i takon ndërmarrjeve publike lokale unë thash në raportimin apo në fjalën hyrëse po ashtu edhe juve e përmendet që ne duhet ti saktësojmë atje kriteret, jo që ndoshta për një shërbim të caktuar po e marrim parkingjet, mbeturinat Ferizaji të veproj ndryshe nga Gjilani apo Prishtina të verpoj ndryshe nga Prizëreni, nuk është se në vend tonë kemi ndoshta me një përjashtim të vogël tek Prishtina ku komunat përafërsisht e kanë të njëjtin zhvillim ekonomik të njëjtin përafërsisht madhësi territorial pra ndryshimi nuk është i madhë që pastaj mund ta determinoj zhvillimin urbanë të qytetit të tyre, për këtë arsye mendoj që do të duhej të ketë edhe një logjik të madhe edhe këtu që këto ndërmarrje publike që themelohen janë tri forma, ose publike ose private ose partneritet publiko-privat. Edhe sot e diskutuam atje ka një formë të katërt që është holding por holdingu i decentralizon ato dhe rrejdhimisht mund ti shtojë edhe efektet negative si korrupsioni dhe se është e kundërta e asaj që pretendohet që gjerat të decentralizohen nga niveli qëndror tek niveli lokal. Për sa i takon PTK-se dhe Trepçës thash, unë mendoj se si proces logjik i hapave që e pasojnë njëri tjetrin do të duhej ta ndiqnin të njëjtin Kuvendi dhe Qeveria pra ti paraprij një plan, strategji pse jo edhe një Ligj por mendoj që tani e kemi edhe më lehtë paraprakisht për arsye që orientimet e partnerëve të kualicionit në kuptimin e ideologjisë ekonomike janë gati të njëjta kështu që vetëm të përgaditën këto gjëra që na japin një orientim të drejtë dhe të sakt. Për sa i takon kodit telefonik është e vërtete ajo që përmendet ju por mos të harrojmë që neve kemi edhe disa zhvillime positive në raport me unionin ndërkombëtar të telekomunikacionit në anën tjetër e dimë që është diskutuar edhe në kuadër të dialogut, kemi zhvillime positive unë për këtë do ti ja jap fjalën edhe Agimit që të mos mbetin edhe këta pa fol edhe njëjtë edhe Ramadanit për atë pjesën që juve e përmendet, unë vetëm edhe një të fundit e kamë që edhe ju të na ndihmoni nëse e shofim sotë strukturën e subvencioneve përsëri edhe z.Ministër Beqaj e dinë unë kam pasur takim edhe me fondin monetar ndërkombëtar dhe për herë të parë ja kam shpjeguar subvencionet në fushën e bujqësisë, pra nuk duhet që neve si struktur sado që fondi mundohet ta

trajtojë si të njëjtë si të plotë të vetëm dhe të pandarë, ne këtu duhet të dimë që brenda sajë pra kemi subvencione në kuadër të pagave kemi subvencionin për shërbime të ndryshme apo siç kemi pasur në të kaluarën Mazutin apo subvencionet që kanë ndodhur këtu për Termokosin dhe për Kosovën B në atë periudhën 12 ditore të ndërprerjes dhe pastaj kemi edhe subvencione të prodhimit që mendojë që sado që hyjnë në një ombrell edhe këtu Kuvendi dhe Komisioni Parlamentar mund të na ndihmoj edhe neve, edhe Ministrinë e tjera sëbashku me Ministrinë e Financave që njëher e përgjithmonë ta zgjedhim këtë problem. Unë u mundova të jem i shkurtër dhe i shpejtë dhe ti përmbledhi të gjitha edhe Agimi për kodin telefonik edhe Ramadani për metodologjinë që e folom për performancën dhe mendoj që për sotë është e mjaftueshme .

Agim Kukaj (MZHE), faliminderit kryetar unë do të jem shumë i shkurtër. Më duket se deputeti Qela e potencojë çështjen e kodit, me të drejtë, neve edhe gjatë kohës së ministrit Beqaj kemi qenë dhe në Shqipëri kemi shquar edhe modalitetet dhe ka qenë plani i gatshëm se si ta shfrytëzojmë 355, mirëpo ndërkohë dialogu me Serbinë dhe është menduar si më e lehtë që të mos komplikojmë kërcejmë nga një kod në kodin tjetër sepse nuk ishte çështje aq e thjeshtë për operatorët që ta ndryshojnë komplet numeracionin edhe për shfrytëzuesit por në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndoshta ta marrim kodin prej ITU-se si duket aq sa neve kemi informacion çështja e kodit ka mbetur pak pezull dhe në dialog për shkaqe politike megjithatë ne po llobojmë edhe si Ministri edhe sëbashku me rregullatorin e telekomunikacionit që gjithsesi me ITU-në ti lidhim ato relacione në mënyrë që ti shofim subvencionet, deri tashti nuk mund të themi që kemi pasur ndonjë sukses substancial sa i përket kodit. Mirëpo po shpresojmë që dialogu me Serbinë që do të jetë ajo rruga më e shkurtër që të klasifikohen disa përpjekje për shkak se nga atje ne do ta marrim kodin e përhershëm e jo nga një të përkohshëm që do të nxjerr telashe në tregun tonë. Desha dhe pak shumë shkurtër edhe për PTK-në ndoshta të hyrat e PTK-së kanë ra ndërsa të dhënat sa i përket tregut të telekomunikimit në telefonin fikse PTK-ja ende i mban 97% të tregut në telefonin mobile në të hyra ka 60% ndërsa në internet diku rreth 23% , nëse vlen të komentohet megjithëate është performancë prap e mirë por nuk do të themë se jemi të knaqr.

Ramadan Sejdiu (MZHE), të nderuar deputet unë do të ju japë një informatë sepse shpesh herë keqinterpretohet nga mediat duhet të ju njohtoj, tek ndermarrjet publike qendrore të cilën neve e kemi përgjegjësi tani e tri vite është krijuar një kulutë e punës të cilët raportojnë në afatet ligjore d.m.th në raportet tre mujore i auditojnë pasqyrat financiare në afate ligjore i punojnë planet e biznesit në afatet ligjore të miratuara natyrisht nga bordi i drejtorëve dhe i punojnë raportet e knaqësisë të konsumatorëve deri tani nuk e kemi asnjë ndërmarrje publike qendrore e cila nuk e ka auditu pasqyrën financiare edhe ato raporte janë të dërguara edhe në bordin e raporteve financiare në ministrinë e financave. Sa i përket raporteve vjetore para publikut d.m.th ku Qeveria raporton , raporti për vitin 2013 e ka kaluar komisionin e ministrave për ndermarrjet publike të Qeverisë së kaluar për shkak të ngërrqit politikë ka pasur ngecje mirëpo raportin për vitin 2014 ne veq kemi filluar ta dizajnojmë dhe po presim që deri në fund të muajit janar ti raportojmë draft pasqyrat financiare ndërsa ato Ligji e thotë që duhet të auditohen deri në fund të muajit Maj.

Kryetari Muhamet Mustafa, falenderoi ministrin dhe bashkëpuntorët e tij për përgjigjet e dhëna duke shtuar se mbikqyrja ndaj ndërmarrjeve publike të fuqizohet, të dihet kush është përgjegjës për mbikqyrjen e zgjedhjes së Drejtorit të PTK-së, Infrakso-it. Kryetari i kërkoj Ministrin të jetë i pranishëm edhe në pikën tjetër të rendit të ditës ku do të shyrqtohet Plani i punës i Komisionit.

Përfundim

1. *Bashkëpunimi të vazhdojë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në bazë të planit të punës së Komisionit për vitin 2015.*
2. *Të kërkohej nga organet kompetente që të shqyrtojnë procedurat e shpalljes së konkurseve për kryeshefat ekzekutiv PTK dhe Infrakos dhe të informojnë Komisionin për rregullsinë e ketyre procedurave në aspektin ligjor dhe përmbajtesor.*

Me kërkesë të Komisionit kjo pikë e rendit të ditës është transkriptuar.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për këtë pikë të rendit të ditës kemi diskutuar që disa herë edhe në mbledhjet e kaluara për hartimin e Planit vjetor të Komisionit për vitin 2015. Ai theksoi se stafi i Komisionit e ka harmonizuar Planin e Punës së Komisionit për vitin 2015 duke u bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2015. Propozoi që në planin e punës të futën dhe strategjitë e Qeverisë siç janë: Strategjia për Postëtelkomin e Kosovës, Energjinë dhe Teknologjinë- informatike. Po ashtu kërkoi që Komisioni në fund të muajit prill ta ketë një informatë nga MZHE-ja lidhur me dinamikën e ligjit për Trepçën.

Besim Beqaj kërkoi që Strategjitë e Qeverisë të mos futen në planin punës përderisa nuk janë miratuara nga Qeveria. Ministria të bëjë analizat e nevojshme për strategjitë, ndërsa për Projektligjin për Trepçën tha që të mbet kompetencë e Qeverisë.

Sala Berisha- Shala propozoi që Komisioni në Planin e Punës t'i fusë për hartim 2 projektligje për Trepçën dhe për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Punëtorëve në Miniera, pasi procedurat e Kuvendit për nisma ligjore janë shumë më të shpjgjeta. Theksoi se gjatë mbikëqyrjes së Ligjit për miniera dhe mineral nga Komisioni Funkcional në mandatin e kaluar, kur është shqyrtuar raporti i monitorimit të ligjit për miniera dhe minerale në seance plenare është rekomanduar që të nxjerrët një ligji i veçantë vetëm për kompleksin Trepça.

Raif Qela propozoi që në planin e punës së Komisionit të futet për hartim Projektligji për Zonën e Rrezikuar të Obiliqit, pasi që edhe mandatin e kaluar ka pasur nismë për hartimin e këtij projektligji nga ana e dy deputetëve të Lëvizjes për Bashkim.

Besim Beqaj tha se është kundër projektligjeve për komuna të caktuara, pasi që mund të hapë tema me shumë konsekuenca. Po ashtu theksoi se projektligji për Zonën e Rrezikuar të Obiliqit ka shumë implikime buxhetore dhe nuk mund të jetë i zbatueshëm.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik- propozoi që Projektligji për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore që të jetë në fillim të marsit, pasi që lidhet me përmbushjen e sfidave të dalura nga raporti i progresit që duhet të jetë i miratuar në muajin qershor.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit

Kryetari i Komisionit, **Muhamet Mustafa,** propozoi që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike të kalojë nga muaj janar në muajin

shkurt, pasi për këtë projektligj na duhet një kohë ma e gjatë e shqyrtimit, ku do të ftojme ekspertë të fushave të ndryshme për të shqyrtuar dhe analizuar mirë në detaje.

Komisioni, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për vitin 2015 më disa ndryshime-plotësime të propozuara nga anëtarët e Komisionit.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit, **Muhamet Mustafa**, i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka ardhur një ftesë për një konferencë parlamentare që mbahet në Tiranë/Shqipëri më 19-20 shkurt 2015 nga Ëestminster Foundation for Democracy (Fondacioni Ëestminster për Demokraci) dhe Rrjeti i Komisioneve Parlamenteve për Ekonomi, Financa dhe Integritet Evropian të Ballkanit Perëndimor (National of Parliament Committees on Economy Finance and European Integration of Ëestern Balkans – NCP), me temë “Mbikëqyrja parlamentare mbi politikën e buxhetit” Tha se për këtë konferencë të ftuar janë vetëm kryetarët e 4 komisioneve të cekura më lart.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00 .

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Muhamet Mustafa